EMRAT/ Po ruanin me armë parcelën me kanabis në malin e Tomorrit, pranga babait dhe dy djemve në Poliçan

26 Gusht, 2023 10:54

Madhësia e tekstit:

Babai dhe dy djemtë janë arrestuar pasi janë kapur të armatosur teksa ruanin parcelën me kanabis në fshatin Tozhar të Poliçanit. Mësohet se në pranga kanë rënë Aurel, Florian, Halil, Dymishi dhe Gëzim Vzhari. Gjithashtu, arrestohet në Durrës pronari i sipërfaqes së tokës ku ishin kultivuar bimët narkotike.

Njoftimi i policisë:

Polican/Finalizohet si rezultat i një hetimi proaktiv, faza e dytë e operacionit policor anticannabis, të koduar "Tomorri".

Të armatosur, ruanin bimët narkotike që kishin kultivuar në fshatin Tozhar, vihen në pranga 3 shtetas (babai dhe 2 djemtë).

Gjithashtu, arrestohet në Durrës pronari i sipërfaqes së tokës ku ishin kultivuar bimët narkotike. Procedohet penalisht vëllai i tij, për posedim pa leje të një arme gjahu.

Asgjësohen nëpërmjet djegies 125 bimë narkotike cannabis sativa dhe sekuestrohen 4 armë gjahu.

Shërbimet e Stacionit të Policisë Poliçan në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Skrapar dhe të DVP Berat, si rezultat i një hetimi proaktiv, të kryer me Prokurorinë e Beratit, për një rast të kultivimit të bimëve narkotike, në fshatin Tozhar, Poliçan, nga disa shtetas, finalizuan fazën e dytë të operacionit policor anticannabis, në nivel qarku, të koduar "Tomorri".

Në kuadër të kësaj faze u arrestuan shtetasit H. D., 58 vjeç, F. D., 32 vjeç dhe A. D., 29 vjeç (babai dhe 2 djemtë). 32-vjeçari u kap në flagrancë teksa ujiste bimët narkotike që kishte kultivuar në fshatin Tozhar, në bashkëpunim me 2 të arrestuarit e tjerë, 125 bimë cannabis sativa të cilat u asgjësuan nga Policia, nëpërmjet djegies. Nga kontrollet, këtyre shtetasve u gjetën dhe iu sekuestruan 3 armë gjahu që posedoheshin pa leje, me qëllim ruajtjen e sipërfaqes me bimë narkotike.

Në vijim të veprimeve procedurale për këtë rast, në bashkëpunim me Policinë e Durrësit, u kap dhe u arrestua shtetasi G. V., 63 vjeç, aktualisht banues në Durrës, pasi bimët u gjetën të kultivuara në tokën në pronësi të tij, në fshatin Tozhar.

Gjithashtu, u referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin H. V., 59 vjeç (vëllai i 63-vjeçarit), banues në fshatin Tozhar, pasi iu gjet në banesë dhe iu sekuestrua si provë materiale, një armë gjahu që posedohej pa leje.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprime të mëtejshme.
[10:50, 26/08/2025] News Titra: Poliçan-arrestuar gjatë fazës së dytë të operacionit "Tomorri", për veprat penale "Kultivimi i bimëve narkotike" dhe "Mbajtja pa leje e armëve të gjahut", shtetasit Aurel, Florian, Halil, Dymishi dhe Gëzim Vzhari.

Proceduar për veprën penale "Mbajtja pa leje e armëve të gjahut", shtetasi Hysen Vzhari.

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: Polican

BW | Merre me Google Play

Kërko këtu

LAJMET E FUNDIT

Vangjel uç opatërnun rijetin, pas zhurmës së krijuar me bëngjë e Lodrit dhe Dufinë Zaqirit, reagon për herë të parë të Elgit Doda
26 Gusht, 2023

"I ruanin me armë" / VOA: Policia djeg mijëra bimë narkotike në malin e Tomorrit dhe arreston disa kultivues e shpërndarës droge
26 Gusht, 2023

Pas shenvreve me produksionin, baleriri Bir Shaqiri rikthehet si krytetar jurie në spektaklin e njohur
26 Gusht, 2023

Vdekja e 17-vjeçarit në Sarandë, reagon ISHMT: Pajisja që pëson defekt nuk lështe ashensor
26 Gusht, 2023

Escobar paralajmëron non grata të nga për korrupsion: Të jesë të sigurt se...
26 Gusht, 2023

Spektakël në Premier League, Manchester United përmbys dy gola, Arsenal ngec në fund
26 Gusht, 2023

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

TË NGJASHME

Adriatik Zotkaj siguron mandatin e 6, PS fiton sërish në Poliçan
11 Maj, 2025

"Autonjësi i mbushur me shisha bire, 4 aksidentët ishin të dehur"/ Del ekspertiza e aksidentit me një vdekësi në Poliçan
Enelda Prenga | 21 Prill, 2025

Taboola Feed

Did You Hear? Celebrities Can't Resist This Dress
Milla | Sponsored
Learn More

This mineral will melt your belly fat fast
well-being-review Elettlivegu | Sponsored

"Festa e beqarisë" kthehet në tragjedi, humb jetën 22-vjeçarja. Sapo doli nga pishina mori...
"Festa e beqarisë" kthehet në tragjedi, humb jetën 22-vjeçarja. Sapo doli nga pishina mori...
balkanweb.com

Electric Bike Prices In 2023 Might Surprise You!
Electric Bikes | Sponsored
Search Now

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

"I ruanin me armë" / VOA: Policia djeg mijëra bimë narkotike në malin e Tomorrit dhe arreston disa kultivues e shpërndarës drogë
26 Gusht, 2023

Vdekja e 17-vjeçarit në Sarandë, reagon ISHMT: Pajisja që pëson defekt nuk lështe ashensor
26 Gusht, 2023

VIDEO/ Përfshihet nga flakët një sipërfaqe me shkurre e pemë frutore në Behli, rrezikohen disa banesa
26 Gusht, 2023

EMRI/ U arrestua pas 10 vitesh arrestl në Laç, kush ishtë shqiptari që importoi 6 tonë kokainë nga Holanda për në Milano
26 Gusht, 2023

Kërkohej në mbi 180 vende, arrestohet në Kolumbi shqiptari i njohur si "El Niko" (EMRI)
26 Gusht, 2023

Ushtrisë dhunë fizike ndaj prindërve, pranga 43-vjeçarit në Pogradec
26 Gusht, 2023

KATEGORIA VIDEO

Spektakël në Premier League, Manchester United përmbys dy gola, Arsenal ngec në fund
26 Gusht, 2023

VIDEO/ Përfshihet nga flakët një sipërfaqe me shkurre e pemë frutore në Behli, rrezikohen disa banesa
26 Gusht, 2023

U arrestua në Tiranë me urdhër të Speciales/ Ish-kryetari i UÇK-së Qirjër reagim nga burgu: Dorës së gjenden në korridorët dhe zyrat e sistemit juridik
26 Gusht, 2023

Po përpiqej të merrte më shumë shkëmbe, youtuberi djeg aksidentalisht Ferrarin e tij
26 Gusht, 2023

Aksidenti te Diga, Gjykata e Tiranës ë në burg pronarin e "BMW X6", ja akuza
26 Gusht, 2023

"Flakët shpërthyen kur dikush u përpoq të bënte një çaj", ndërtë të vdekur nga zjarri në një vagon treni në Indi
26 Gusht, 2023

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.